

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "HEAVY EQUIPMENTS SERVICES
"SH.P.K.

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR
HEAVY EQUIPMENTS SERVICES
SH.P.K**



**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
HEAVY EQUIPMENTS SERVICES
SH.P.K.**

**KREU I
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1
EMRI I SHOQËRISE**

1.1 Sot,në Tiranë më datë 23.09.2022, ne të nënshkruarit:

Lulzim Kapllanaj, atësia Isuf, shtetas Shqiptar, lindur në Fratar, Fier, me datë 15/11/1984 dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim nr. 030037956, numër personal I41115138A, madhor dhe më zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Renis Hoxhaj, atësia Haki, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, me datë 18/01/1980, identifikuar me letërnjoftim nr.036376646, numër personal I00118030H, madhor dhe më zotësi të plotë juridike për të vepruar.

themelojmë këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **HEAVY EQUIPMENTS SERVICES.SH.P.K.**

(Më poshtë e quajtur "**Shoqëria**")

**NENI 2
SELIA**

2.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë Vorë Gjokaj, KM 10, autostrada Tiranë -Durrës, zona kadastrale nr. 1751, me nr.Pas. 40/19.

2.2 Ortakët mund të vendosin mbi transferimin e selisë së shoqërisë në një adresë tjeter. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

3.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

4.1 Shoqëria ka për objekt të saj. *Riparim, i mjeteve motorrike dhe motorçikletave. Shit-blerjen me shumicë e pakicë pjesëve të këmbimit, servis, diagnostikimi i problemit në terren, makineri e paisje, materiale ndërtimi, automjete, vajra lubrifikantë, duke përcaktuar, por pa kufizuar veprimet e papërmëndura, dhënje me qira të makineri e paisje.*

Shoqëria gjithashtu mund të realizojë bashkëpunime me shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objektiv ose të ngjashëm me atë të shoqërisë, si dhe në raste të vecanta në sektorë të tjerë, bashkëpunime me persona fizikë, vetëm nëse keto veprime janë të quajtura të nevojshme ose të duhura për realizimin e objektivit të shoqërisë nga organi administrativ.

4.2 Për më tepër shoqëria mund të vaproje si agjent/ndermjetes për kryerjen e aktiviteteve të mësipërme dhe bazuar në diskrecionin e saj të vetëm mund të kontraktoje palë të treta për kryerjen e një pjese apo të të gjitha sherbimeve te mesiperme.

4.3 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryeje çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të saj përfshirë edhe aktivitetin e ofrimit te shërbimeve, tregtimin, importimin dhe eksportimin e mallrave etj.

4.4 Për të arritur objektin e saj, Shoqëria mund të realizoje drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë cdo lloj pjesemarrje në shoqëri të tjera shiptare apo të huaja, si edhe të hyje ne marrëdhene kontraktore, bashkëpunimi ose ortakërie me persona të tretë, privatë ose publike, vendas ose te huaj.

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i përbërë nga 2 (dy) kuota, të ndarë si më poshtë:

Lulzim Kapllanaj, person fizik, zotëruesh i 1 (një) kuote me 70% (shtatëdhjetë përqind) dhe vlerë 70.000 (shtatëdhjetë mijë) lekë.

Renis Hoxhaj, person fizik, zotëruesh i 1 (një) kuote me 30% (tridhjetë përqind) dhe vlerë 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

Derdhja e kapitalit do të kryhet pas regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të shoqërisë.

NENI 6
TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT

6.1 Transferimi i kuotave të kapitalit të shoqërisë mund të bëhet me shitje, trashëgimi, ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga ligji.

6.2 Në rast transferimi të kuotave tëk persona të tretë jashtë Shoqërisë, qoftë me shitje qoftë me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet t'i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta.

6.3 Vlera e kuotës që transferohet do të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marrëveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakort.

NENI 7
BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT

7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rëndohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale

KREU III
ORTAKËT E SHOQËRISE, FINANCIMET

NENI 8
ORTAKËT

8.1 Ortakët e shoqërisë janë:

Lulzim Kapllanaj, atësia Isuf, shtetas Shqiptar, lindur në Fratar, Fier, me datë 15/11/1984 dhe banues në Tiranë, identifikuar me letërnjoftim nr. 036489901, numër personal I41115138A, madhor dhe më zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Renis Hoxhaj, atësia Haki, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Tiranë, me datë 18/01/1980, identifikuar me letërnjoftim nr.036376646, numër personal I00118030H, madhor dhe më zotësi të plotë juridike për të vepruar.

NENI 9
ORGANET E SHOQËRISE

9.1 Organet e shoqërise janë:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Administratorët.



Neni 10
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërise dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

10.3 Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji për shoqëritë tregtare, ligje të tjera, dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërise.

10.4 Asambleja e Përgjithshme mbahet ne selinë e Shoqërise ose në çdo vënd tjetër të shënuar në njoftimin përmes njohjeve. Njoftimi përmes njohjeve i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpëra datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të permbarë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.

10.6 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të zakonshme e jashtezakonshme.

Neni 11
ASAMBLEJA E ZAKONSHME


11.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brënda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit finanziar, përmiratimin e raportit të administratorëve, inventarëve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren më shumicë të zakonshme të votave në prani të ortakëve me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 50 % të kuotave.

11.3 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 11.2, Asambleja do të mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njejtin rend dite. Në rast se as në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi, ortakët e pranishëm ose rregullisht të përfaqësuar do të përbëjnë kuorumin.

Neni 12
ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME

12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të jashtezakonshme sa herë është e nevojshme përmarrjen e vendimeve në interes të Shoqërise.



12.2 Vendimet që kanë të bëjnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e neneve të Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, prishjen e Shoqërisë konsiderohen vendime të jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Përgjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave në prani të ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

12.4 Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 diteë me të njëjtin rend dite. Në rast se në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi, ortakët e pranishëm ose rregullisht të përfaqësuar do të përbëjnë kuorumin.

Neni 13 **PJESËMARRJA, VOTIMI DHE PËRFQAQËSIMI**

13.1 Secili ortak ka të drejtën e pjesemarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.

13.2 Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

Neni 14 **KOMPETENCAT E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

14.1 Asambleja e Peërgjithshme vendos për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe caktimin e shpërbimit të tij/tyre;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatori/eve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar dhe shpërbilimin e tyre;
- e) mbikyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) perfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera në kundër administratorit/ëve;

- j) shpërndarjen e fitimeve;
- k) riorganzimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të Asamblesë;
- m) çështje tjeter të caktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- n) Kërkesa për kredi bankare dhe / ose nënshkrimit të faturave, garanci ose garanci në favor të palëve të treta.

NENI 15 **FINANCIMI I SHOQËRISË**

15.1 Organi i administrimit të shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përvet rasteve të zmadhimit te kapitalit ka të drejte të kërkoje nga ortaket e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë

15.2 Financimet e mëtejshme të ortakeve në shoqeri do të jene me shperblim (interesa) apo pa shperblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të levrohen këto fonde.

KREU IV **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

NENI 16 **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

16.1 Shoqëria administrohet nga një Administrator ;

- **Znj.Liljana Hyseni**, atësia Demir, shtetase Shqiptare, në Farret/ Librazhd, banuese në Tiranë, e identifikuar me letërnjoftim nr.034104432 dhe numër personal I45808058B, madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, e cila emërohet nga ortakët e shoqërisë për një periudhë 5 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori shkarkohet nga detyra, ne çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit te Shoqërisë.

Administratori ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit të shoqërisë;
- b) përfaqëson shoqërinë;
- c) kujdeset që shoqëria të zbatojë ligjet dhe standartet e mbajtjes së llogarive;
- d) përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shperndarjen e fitimeve ja paraqet Asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe rapporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklarim tjeter i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "HEAVY EQUIPMENTS SERVICES "SH.P.K.

- f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të çertifikuar dhe raporti i llogaritareve publike të çertifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
- g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencen e Shoqërisë;

16.2 Administratori mund të ndërmarrë apo të kërkoi kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë pavec atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve të tjera të Shoqërisë.

**NENI 17
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

17.1 Shpërbimi i administratorit të shoqërisë do të përcaktohet nga Ortaku i shoqërisë.

**KREU V
KONTROLLI KONTABËL I SHOQËRISË
VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

**NENI 18
KONTROLLI KONTABËL**

18.1 Kontrolli i jashtem kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabel të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ortakët do të emerojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në baze të ligjit.

**NENI 19
VITI FINANCIAR**

19.1 Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti.

**NENI 20
BILANCI DHE REZERVAT**

20.1 Me mbylljen e secilit vit finanziar Administratorët marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin finanziar të mbyllur ne mënyrë qëortaket të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividentëve që rezultojne si fitime sipas bilancit te miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

20.3 Ortaket në cdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre



KREU VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET

NENI 21
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

21.1 Në rastin e likuidimit të shoqërisë do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqeritë Tregtare"

NENI 22
NJOFTIMET

22.1 Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nese ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre prane Administratoreve të Shoqërisë.

22.2 Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjisacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të déklaruara prej tyre.

22.3 Në rastin kur një kuote zotërohet nga më shume se një përsone të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqesuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

KREU VII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 23
LIGJI I ZBATUESHËM


23.1 Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelin, Statutn dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjisacionit shqiptar ne fushën e shoqërive tregtare.

23.2 Ky akt hartohet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortakët themelues, firmoset si më poshtë prej tyre.

Ortakët Themelues:

Lulzim Kapllanaj

Renis Hoxhaj




RENISS. HOXHAJ